



Duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të Komunës të datës 08.02.2007 01 nr 36 për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores mbi caktimin e tatimit në pronën banesore – afariste dhe industriale në Komunën e Suharekës të protokolluar 01 nr 207 të datës 20.12.2005, Kryetari i Kuvendit me datë 14.03.2007 nxjerr tekstin e spastruar të kësaj rregullore si vijon:

R R E G U L L O R E

MBI CAKTIMIN E TATIMIT NË PRONËN BANESORE-AFARISTE DHE INDUSTRIALE NË KOMUNËN E SUHAREKËS

Neni 1

Me këtë Rregullore vendoset tatimi mbi pronën e paluajtshme banesore-afariste dhe industriale, kriteret për caktimin e **BAZËS** tatimore, shkallën e tatimit, vlerësimin e pronës, shuma e detyrimit dhe ndarja e zonave.

Neni 2

Me pasuri të paluajtshme kuptojmë tokën, objektet, instalimet, strukturat të cilat janë të lidhura për tokën e që nuk mund të lëvizin pa dëmtimin e përbërjes apo strukturës së saj konstruktive.

Neni 3

Në bazë të kësaj Rregullore do të tatimohen pronat banesore, tregtare dhe ato industriale që janë pronë private dhe pronë e ndërmarrjeve në pronësi publike/shoqërore.

Neni 4

Kriter për caktimin e **BAZËS** tatimore do të jetë vlera e pronës së paluajtshme.

Në bazë të kësaj Rregullore vlera e pronës së paluajtshme do të caktohet në bazë të vlerës së **shitjes - -blerjes për një (1)m²** në vendndodhjen e objektit.

Në rast se nuk mund të caktohet vlera e pronës së paluajtshme në bazë të këtij kriteri, atëherë vlera e tregut mund të përcaktohet duke iu referuar të ardhurave që krijohen nga kjo pasuri.

Neni 5

Baza tatimore e pronës caktohet në bazë të çmimit kushtues për m² të shitë - blerjes të banesës, shtëpisë dhe objekteve afariste/komerciale (çmimi i tregut).

a) Baza tatimore e banesave:

Për Zonën e parë (I).....450,00 € për m²

b) Baza tatimore e shtëpive:

Për Zonën e parë (I)400,00 € për m²

Për Zonën e dytë (II).....350,00 € për m²

Për Zonën e tretë (III).....300,00 € për m²

Për Zonën e katërt (IV)..... 250,00 € për m²